



INSTITUCIONI I AVOKALIT TË POPULLIT
Republika Kosova • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokalit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 2140/2019
Nr./f/Br.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 16/12/19

PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution



LETËR REKOMANDIMI

përkitazi me

vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan të Mekanizmit Kombëtar për Parandalim
të Torturës

Për: Z. Abelard Tahiri, Ministër
Ministria e Drejtësisë

Z. Qemajl Marmullakaj, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Drejtësisë

Z. Uran Ismaili, Ministër
Ministria e Shëndetësisë

Z. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Shëndetësisë

Z. Milazim Gjocaj,
Drejtor i Departamentit të Shëndetësisë në Burgje

Z. Nehat Thaçi, u.d. Drejtor i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës

Z. Shefik Sylejmani, Drejtor
Qendra e Paraburgimit në Gjilan

Prishtinë, 16 dhjetor 2019

Qëllimi i vizitës

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshmë: MKPT) i Avokatit të Popullit, më 13 nëntor 2019, e ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Gjilan (në tekstin e mëtejshmë: QPGj). Qëllimi i vizitës ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të MKPT-së të dërguara përmes raportit me rekomandime të datës 27 mars 2018.¹

Bashkëpunimi me MKPT-në gjatë vizitës

Gjatë vizitës së MKPT-së në QPGj, personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e QPGj-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa praninë e zyrtarëve korrektues ose të personelit tjetër.

Keqtrajtimi fizik

MKPT-ja, gjatë vizitës në QPGj, ka intervistuar një numër të konsiderueshmët të të paraburgosurve dhe të të dënuarve dhe nuk ka marrë asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Po ashtu nuk ka marrë asnjë ankesë lidhur me sjelljet e zyrtarëve korrektues, të cilat do të përbënë trajtim që nuk është në pajtim me respektimin e dinjitetit njerëzor të të burgosurve.

Gjatë vizitës është vërejtur komunikim interaktiv dhe miqësor ndërmjet personelit korrektues dhe të burgosurve. Po ashtu, MKPT-ja nuk ka marrë nga të burgosurit asnjë pohim për korruption. Për më shumë, në këtë qendër akomodohen edhe të burgosurit e përkatësive të tjera etnike. MKPT-ja ka vërejtur se nuk u shënua asnjë incident ndërmjet të burgosurve të përkatësive të ndryshme etnike.

Rekomandimet e MKPT-së të dërguara përmes raportit të publikuar më 19 mars 2018

- 1. Ministria e Drejtësisë ta njoftojë MKPT-në e Avokatit të Popullit lidhur me planifikimet për shfrytëzimin e hapësirës së pabanuar në QPGj.** Lidhur me këtë, MKPT-ja ka marrë një shkresë zyrtare nga ministri i Drejtësisë, në të cilën janë sqaruar planet për të ardhmen. Gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur se është rritur numri i të burgosurve, QPGj-ja është pajisur me inventar dhe me personel korrektues, në pajtim me rritjen e numrit të të burgosurve.
- 2. Avokati i Popullit të njoftohet lidhur me ngecjet në krijimin e hapësirës për montim të karriges stomatologjike.** Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se shërbimet stomatologjike tani janë në dispozicion të të burgosurve dhe kjo mangësi është evituar.
- 3. Të sigurohen aktivitete kulturore, sportive dhe programe për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve.** MKPT-ja ka vërejtur se, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve kompetente, aktivitetet e mirëfillta të cilat do të ishin në shërbim të risocializimit të mirëfilltë të të burgosurve, megjithatë mbeten të pakta. MKPT-ja vëren se, sa i përket angazhimit në punë të të paraburgosurve, neni 199, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Penale përcakton si në vijim: “*I paraburgosuri mund të kryejë*

¹ MKPT, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, publikuar më 19 mars 2018.

punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t'i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”

Ndërsa nen 200, paragrafi 1, i LESP-së, lidhur me angazhimin e të paraburgosurit në punë, përcakton si në vijim: “*I paraburgosuri mund të angazhohet me punë në punëtori, punëtoritë e njësive ekonomike të cilat gjenden në rrëthin e institucionit korrektues përkates pas marrjes së pëlgimit të gjykatës kompetente.*”

Po ashtu, Rregullat e Mandelës përcaktojnë të drejtën e të paraburgosurit për të punuar. Në Rregullin 116 të Rregullave të Mandelës shprehimisht theksohet: “*Të paraburgosurit duhet ti ofrohet mundësia të punojë, por nuk duhet ti kërkohet të punojë. Nëse ai/ajo përcaktohet që të punojë, ai/ajo duhet të paguhet.*”

Në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, i cili ishte publikuar në vitin 2016, KPT-ja, lidhur me regjimin për të paraburgosurit, kishte shprehur shqetësimin që, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve, të paraburgosurit shumicën e kohës e kalojnë në qelitë e tyre, përveç dy orëve të shëtitjes në ditë, duke shikuar TV dhe duke luajtur me letra.

Përmes këtij raporti, KPT-ja u kishte rekomanduar autoriteteve kompetente në Republikën e Kosovës, si në vijim: “*KPT, ri-përsërit rekomandimin që autoritetet të angazhohen që të rrisin aktivitetet jashtë qelisë për të paraburgosurit në të gjitha institucionet të cilat KPT i vizitoi, dhe në të gjitha institucionet tjera të Shërbimit Korrektues të Kosovës ku një gjë e tillë është e përshtatshme.*”

Më tej KPT-ja thekson: “*Sa më e gjatë që është periudha e paraburgimit, aq më shumë duhet të zhvillohet regjimi i cili u ofrohet atyre. Po ashtu, duhet të ndërmerrin veprime që edhe numri i personelit, ku një gjë e tillë është e nevojshme, të rritet.*”

MKPT-ja konsideron se, bazuar në legjislacionin në fuqi, në Rregullat e Mandelës dhe në rekomandimet e KPT-së, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që të rriten angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit, jo vetëm në QPP, por edhe në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur.

4. **Të asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltuar, e cila mund të paraqesë vështirësi serioze gjatë stinës së dimrit dhe në kushte të reshjeve atmosferike për kryerjen e punës së QPGj-së, në pajtim me LESP-në.**

Është e quartë për MKPT-në se nuk është në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë dhe as e Shërbimit Korrektues të Kosovës që të asfaltojë rrugë, por është obligim i këtyre dy institucioneve që ta adresojnë këtë çështje tek organet kompetente. Terreni në të cilin gjendet QPGj-ja, gjatë stinës së dimrit dhe gjatë reshjeve atmosferike, mund ta vështirësojë shumë punën e institucionit. Për më shumë, kjo pjesë e rrugës deri tek QPGj-ja mund të përbëjë edhe rrezik për jetën e të burgosurve dhe të personelit korrektues, i cili bën transportin e tyre jashtë institucionit. Gjatë vizitës së fundit, MKPT-ja ka vërejtur se, pavarësisht përpjekjeve të drejtorisë së QPGj-së, nuk pati progres në zbatimin e këtij rekomandimi të MKPT-së.

5. **QPGj-ja tē furnizohet me materiale tē nevojshme pér punë.** Gjatë vizitës së fundit, MKPT-ja u njoftua se pati furnizime me materiale pér punë pér zyrtarët korrektues dhe pér pjesën tjeter tē personelit tē QPGj-së.
6. **Tē instalohen kamerat e sigurisë, tē cilat mbulojnë pjesën e jashtme tē pavijoneve dhe oborrin e QPGj-së.** Gjatë vizitës së fundit përcjellëse, MKPT-ja u njoftua se kamerat e sigurisë u instaluan aty ku mungonin, por ka mangësi tē shumta teknike nē funksionimin e tyre. MKPT-ja konsideron se këto mangësi teknike duhet tē evitohen, pasi që kamerat e siguriçë, sipas standardeve ndërkombëtare pér tē drejtat e tē burgosurve, konsiderohen si garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik dhe njëkohësisht garanci se personeli i sigurisë nuk do tē akuzohen rrejshëm pér keqtrajtim fizik.

7. **Tē funksionalizohet ashensori nē pjesën ku ofrohen shërbimet mjekësore.**

Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se ashensori ende nuk është funksional. MKPT-ja konsideron se funksionalizimi i ashensorit do ta lehtësonte qasjen e tē burgosurve me aftësi tē kufizuara dhe do ta lehtësonte edhe punën e personelit mjekësor.

Gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka marrë shqetësimet e drejtorit pér shkak tē numrit të vogël tē punëtorëve socialë (tash pér tash vetëm një punëtor social) bazuar nē numrin e tē burgosurve që shënoi rritje. Sipas drejtorit, procedurat e rekrutimit kanë dështuar. **MKPT-ja konsideron se rritja e numrit tē punëtorëve socialë është e domosdoshme tē t'u ofruar shërbime adekuate tē burgosurve.**

Në bazë tē tē gjeturave dhe tē konstatimeve tē arritura gjatë vizitës, nē pajtim me nenin 135, paragrafi 3, tē Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, tē Ligjit 05/L-019 pér Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon

Ministrisë së Drejtësisë:

- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që tē sigurohen më shumë aktivitete kulturore, sportive dhe programe pér rehabilitim dhe pér risocializim tē tē burgosurve.
- MKTP-ja ripërsërit rekomandimin që tē asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltuar, e cila, gjatë stinës së dimrit dhe nē kushte tē reshjeve atmosferike, mund tē paraqesë vështirësi serioze pér kryerjen e punës së QPGj-së, nē pajtim me LESP-në.
- Tē rritet numri i punëtorëve socialë bazuar nē numrin e tē burgosurve.
- Tē evitohen mangësitë teknike pér funksionimin e kamerave tē sigurisë.
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që tē funksionalizohet ashensori nē pjesën ku ofrohen shërbimet mjekësore.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, tē Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushton pushtet legitim nē Republikën e Kosovës, është i*

detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit, të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligj") dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit ("Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë"), ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit